



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

| | | | |
|---|-------------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|
| Pranuar / Dostignut Prenheno / Predato Received / Delivered | 12.07.2023 | viti year | 3 |
| Organ / Njësia Organ / Jednitsa Org. titull | Et. Prot. Et. Prot. Prot. No. | Shtojca Prilog Appendix | Sasia Kolicina Quantity |
| SKM5HCK | 5791/2023 | | 114 |



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.730/2019

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi-anëtarë, me Rushit Kajtazi Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësi të procesmbajtësit, duke vepruar sipas Aktgjykimit A.nr.130/2020 të datës 03.05.2023 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.730/2019 të datës 12.12.2019, të parashtruar nga ankuesit

kundër organit të punësimit Ministria e Shëndetësisë, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafi 1.1 nënparagrafi 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr. 03/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 11.07.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.730/2019 e datës 22.11.2019, e parashtruar nga ankuesit

A r s y e t i m

Grup ankuesish

që të gjithë nëpunës civilë të punësuar në Ministrinë e Shëndetësisë, më datë 22.11.2019 kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, kundër aktit/njoftimit më numër protokollit 05-5428/2 të datës 11.10.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Aneksive të Ministrisë së Shëndetësisë, me pretendimin së kjo e fundit ka bërë cenim të së drejtës së nëpunësve civilë të garantuar me kreun VI të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil (tutje vetëm Këshilli) në mungesë të kuorumit për vendosje, përmes shkresës me numër protokollit 5792/2019 të datës 12.12.2019, ka njoftuar

ankuesit lidhur me arsyet e mos shqyrtimit të ankesës, duke udhëzuar të njëjtën lidhur me të drejtën e inicimit të konfliktit administrativ në gjykatën kompetente.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative me Aktgjykimin A.nr.132/2020 të datës 25.05.2021, ka detyruar Këshillin që të shqyrtoj dhe të vendos lidhur me ankesën A.nr.730/2019, ndërsa Këshilli serish më datë 07.07.2021 përmes njoftimit me numër protokoll 3520/21 ka informuar ankuesit se nuk mund të vendoset lidhur me këtë çështje, për shkak që Këshilli nuk ka kuorum, duke udhëzuar të njëjtin që t'i ndjek procedurat e mëtejme në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ. Ankuesi ka ndjekur procedurat gjyqësore dhe si rrjedhojë ka hapur konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative më Aktgjykimin A.nr. 130/2020 të datës 03.05.2023, serish ka detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që të shqyrtoj dhe të vendos lidhur me ankesën e parashtruar nga ankuesi të datës 22.11.2019.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 5496/2019 të datës 22.11.2019 të parashtruar nga ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shënimin Civil të Kosovës; Aktgjykimin A.nr.132/2020 të datës 25.05.2021, të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative; Aktgjykimin A.nr.32/2020, të datës 03.05.2023, të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative; Njoftimin me numër protokoll 3520/2021, të datës 07.07.2021 të KPMSHCK; Njoftimin me numër protokoll 5792/2019 të datës 12.12.2019 të KPMSHCK; Njoftimin me numër protokoll 05-542/2 të datës 11.10.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Lista e pagave (pa shënime lidhur me periudhën) se bashku me deklaratën e datës 09.10.2017, Akt Emërimit me numër rprotkoll 2512 të datës 31.10.2013 për nëpunësen civile Akt Emërimit më numër protokoll 2514 të datës 31.10.2013 për nëpunësin civil se bashku më përshkrimin e detyrave të punës për pozitën e punës Inspektor farmaceutik; Ankesën me numër protokoll 05-5428 të datës 08.10.2023 për nivelizimin e pagës; Përgjigjen në ankesë me numër protokoll 05-3677/2 të datës 15.08.2019; Vendimin me numër protokoll 05-4029 të datës 26.07.2019 mbi themelimin e Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Ankesën me numër protokoll 05-3677 të datës 10.07.2021, ankesën pa datë dhe numër protokoll; Kërkesën për nivelizimin e pagës me numër protokoll 05-949 të datës 14.02.2018; Shkresën me numra protokoll 05-554 të datës 09.12.2010; Shkresën me numër protokoll 05-3217 të datës 30.05.2016 me titull kërkesë për aprovimin të procedurave të pagesës së rrezikshmërisë së stafit të Inspektoratit Shëndetësorë; Memorandum i Mirëkuptimit (data dhe numri i protokollit i paidentifikuar) se bashku me shkesat e përcjella numër faqe 34/39; shkresa BL 7731 me Kod 10-72400-206-074; listat e pagave për periudhën 01.10.2017 deri në 31.10.2017 faqe nr.41/46; Përgjigjen në ankesë me numër protokoll 5680/2019 të datës 05.12.2019; Akt emërimit Nr.165 të datës 09.10.2017 për ankuesin se bashku me Deklaratën e datës 09.10.2017 për pranimin e kushteve të punës; Akt Emërimit Nr.192 të datës 26.09.2019 se bashku me Deklaratën e datës 26.09.2019 për pranimin e kushteve të punës; Akt Emërimit Nr.160 të datës 09.10.2019 së bashku me Deklaratën e datës 09.10.2019, Akt Emërimit Nr.161 të datës 09.10.2017 së bashku me Deklaratën e datës 09.10.2017; Akt Emërimit Nr.164 të datës 09.10.2017 së bashku me Deklaratën e datës 09.10.2017, certifikatën nën hetime penale P.nr.6403/2017 e datës 10.10.2017; Akt Emërimit Nr.163 të datës 09.10.2017 së bashku me Deklaratën e datës 09.10.2017; Akt Emërimit Nr.162 të datës 09.10.2017 së bashku me Deklaratën



e datës 09.10.2017 se bashku me deklaratën e datës 09.10.2017' Kartela e nëpunësit për vitin 2019; Kartela për nëpunësin e vitit 2019; Kartela e nëpunësit Besim e vitit 2019; Kartela e nëpunësit Zogaj e vitit 2019; Kartela e e vitit 2019; Kartela e nëpunësit e vitit 2019; Kartela e nëpunësit Jehonë e vitit 2019; provat shtesë të përcjella përmes shkresës me numër protokolli 499/2023 të datës 11.07.2023 faqe 1/52.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankueseve *është parashtruar jashtë afatit ligjor, sepse:*

Sipas provave të lëndës konstatohet fakti së ankuesit si në dispozitiv të këtij vendimi që të gjithë janë të punësuar në Inspektoratin Farmaceutik pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe së të njëjti ushtrjnë pozitën e punës Inspektorë Farmaceutik.

Ankuesit më datë 08.10.2019 kanë parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Shëndetësisë, për nivelizimin e pagës, ndërsa Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Shëndetësisë me datën 11.10.2019 përmes aktit me numri protokolli 05-5428/2 ka njoftuar ankuesit se pas hyrjes në fuqi të Ligjit nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nuk ka legjitimitet për shqyrtimin e ankesës dhe e ka udhëzuar ankuesit që të parashtrorjnë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Në kuptim të pranueshmerisë së ankesës, Kolegji i Këshillit i'u referua nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative me të cilin është përcaktuar se: 1. *Ankesa është e pranueshme nëse i plotëson këto kushte: 1.1. nuk është përjashtuar shprehimisht nga ligji; 1.2. ankuesi ka legjitimitet në përputhje me nenin 124 të këtij Ligji; 1.3. ajo është parashtruar brenda afatit të parashikuar nga neni 127 i këtij ligji, dhe 1.4. çfarëdo kushte të tjera të parashikuara shprehimisht në ligj.* Ndërlidhur me këtë me nenin 127 të të njëjti ligj parashihet se: "1. *Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ.* 4. *Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ..."* nisur nga ky përcaktim ligjor dhe duke u bazuar në shkresat e lëndës Kolegji ka konstatuar së ankuesit aktin-Njoftimin me numër protokolli 05-5428/2 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave e kanë pranuar me datë 11.10.2019 (datë kjo e konfirmuar nga vet ankuesit në parashtrësën e ankesës), ndërsa ankesën në Këshill kundër këtij akti e kanë parashtruar me datë 22.11.2019, andaj mbi këtë bazë rrjedhë së ankesa A.nr.730/2019 e datës 22.11.2019 është parashtruar jashtë afatit ligjor të përcaktuar me dispozitat e nenit 127 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, rrjedhimisht ankesa e ankuesve nuk është e pranueshme në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nen paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Theksuar si me lart, e në mbështetje të dispozitave të nenit 18 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-



Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.730/2019

Rushit Kajtazi



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesve;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Shëndetësisë; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

Ardita Haxhnikaj-Demi

